

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISÉ-OPŠTINA VUČITRN	
01 Nr. / Br	273/23
Nr. i fq. / Br. st	- 6 -
Data: / Datum	13.12.2023
VUSHTRRI - VUČITRN	



**REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA**

**KOMUNA VUSHTRRI
OPŠTINA VUČITRN**

PROCESVERBAL

në mbledhja e XI-të e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 16 nëntor 2023 në sallën e kuvendit të komunës, e cila filloj në ora 10:15.

Në mbledhje ishin të pranishëm: Melihate Basholli-Latifi (kryesuese), Ilmi Azemi, Nurie Halili, Agron Përçuku, Alban Bajrami, Fakete Dushi, Sylejman Mehollı dhe Fatmire Cecelia (anëtarë të KPF-së).

Gjithashu në këtë mbledhje morën pjesë edhe: Ferit Idrizi (Kryetar i Komunës), Shpëtim Zhegrovë (Nënkyetar i Komunës), drejtoret e drejtorive, Qemajl Hasani, kryesues Komisionit Komunal të Aksionarëve i N.P.L. "Përparimi" SH.A, si dhe Bujar Klinaku nga sekretaria e kuvendit.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoit Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit dhe e KPF-së, e cila konstatoi se ekziston shumica e mjaftueshme për punë.

Ajo theksoi se për anëtarin e ri të KPF-së, Mentor Hasanin ende nuk kemi marrë konfirmim të ligjshmërisë së vendimit nga MAPL-ja. Prandaj, Mentorin e kemi njoftuar për këtë çështje.

Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së – propozoi që të futet në rend të ditës financimi i librit të autorit, Gëzim Sarac. Ky libër është duke u bërë për Batalionin e Parë të Brigadës 142 të Zonës Operative të Shalës të UÇK-së. Ky libër është mbështetur me disa mijete nga Ministria e Kulturës, por nuk po i mjaftojnë mjetet financiare për ta përfunduar.

Ferit Idrizi, Kryetar i komunës – theksoi që kërkesa le të vjen tek unë dhe ne e përgatisim materialin për KPF dhe kuvend.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi këtë:

R E N D D I T E

- Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 13.10.2023;
- Shqyrtimi i Raportit i Komisionit Komunal të Aksionarëve i N.P.L. "Përparimi" SH.A për vitin 2022;
- Shqyrtimi i Propozim – vendimit për caktimin e normave tatimore të pronave;
- Shqyrtimi i Informatës lidhur me zbatimin e Planit Zhvillimor Komunal;
- Shqyrtimi i Informatës lidhur me rezultatet (ecurinë) e dhënies në shfrytëzim të pronës komunale;
- Shqyrtimi i Informatës për menaxhimin e mbetjeve në Komunën e Vushtrrisë;

7. Shqyrtimi i Informatës lidhur me strukturën e bizneseve, numrin e të punësuarve dhe zhvillimin e bizneseve në Komunën e Vushtrrisë;
8. Të ndryshme.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 13.10.2023.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi procesverbalin e datës 13.10.2023.

2. Shqyrtimi i Raportit i Komisionit Komunal të Aksionarëve i N.P.L. "Përparimi" SH.A për vitin 2022.

Sylejman Meholli, anëtar i KPF-së – tha se ky është një raport që është kërkuar që një kohë të gjatë. Ne jemi në përfundim të vitit 2023, kurse reporti ka ardhur për vitin 2022 që është tepër i vonuar. Mirëpo, reporti nuk përmban atë që ne e kemi kërkuar – numri i të punësuarve. Prandaj, për kuvend ai kërkoi që këtij reporti t'i bashkëngjitet lista e të punësuarve, sidomos për për periudhës janar 2022 e deri në nëntor 2023.

Ai tha se ka informata jozyrtare që është abuzuar me punësimin, shpresojmë se nuk janë të vërteta, saqë është rrezikuar stabiliteti financiar i kësaj ndërmarrje.

Ferit Idrizi, Kryetar i komunës – nëse vjen lista e të punësuarve, ai propozoi që të bëhet që nga themelimi i ndërmarrjes e deri në nëntor 2023 dhe mënyra e pagesës së tyre në atë kohë edhe tash. Pra, gjithçka le të jetë transparente.

Agron Perçuku, anëtar i KPF-së – për shkak se kryesuesi i komisionit të aksionarëve është ndërruar, kjo mund të jetë edhe vonesa e këtij reporti. Kur Ligji i Pagave hyri në fuqi, gjendja ekonomike e qytetarëve ishte vështirësuar, çmimet u ngritën. Shumë kompani iu ngritën pagat punëtorëve të tyre, si kompania "Uniteti" ua ngriti për 100 euro pagat e punëtorëve. Kryetari në një takim me punëtorët e ndërmarrjes "Përparimi" iu premtoi rritjen e pagave prej 20%. Bordi i ndërmarrjes ka marrë vendim për ngritjen e pagave të punëtorëve për 20%. Kryetar, a jeni në dijeni që ky bord ka marrë vendim, duke i diskriminuar disa punëtorë, sepse nuk janë ngritur për të gjithë punëtorët? Ai kërkoi që të publikohet vendimi i bordit për ngritjen e pagave të kësaj ndërmarrjeje që ta dimë se ku është problemi tek bordi apo tek menaxhmenti, sepse ka ankesa nga punëtorët.

Ferit Idrizi, Kryetar i komunës – theksoi se me mbështetjen tonë janë ngritur pagat. Përndryshe, kompania është e pavarur në fushën e veprimeve. Nuk kemi informacion për këtë vendim për ngritje të pagave se çfarë përmban, por do të interesohem për këtë çështje.

Shpëtim Zhegrova, Nënkyetar i komunës – tha se tash mora informacion nga kryeshefi i ndërmarrjes (sepse as ne nuk kemi qenë në dijeni) se ngritja e pagave të ndërmarrjes "Përparimi" është bërë për të gjithë: punëtorët e sigurimit, punëtorët e hapësirave publike, punëtorët e pastrimit. Me përashtim të punëtorëve të administratës (7 apo 8 të punëtorë) që nuk janë përfshirië në këtë ngritje të pagës. Nëse ka ndonjë rast të caktuar është mirë që të të ceket në mënyrë që të identifikohet.

Agron Perçuku, anëtar i KPF-së – është fakt kjo që e tha nënkyetari, sepse kështu është bërë ngritja. Sepse, qysh ka mundësi që një mbikëqyrës ta ketë pagën më të vogël se punëtori. Këtu është bërë diskriminim. Prandaj, ai kërkoi që vendimi të bëhet publik. Lidhur me listën e të punësuarve, është mirë të konsultoheni, se a është konfidenciale.

Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim. Kurse, u kërkua që të bisedohet me Zyrën Ligjore se a është shkelje e të drejtave të njeriut dhe konfidenciale publikimi i listës së të punësuarve.

Melihate Basholli - Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së – tha se do të konsultohemi me Zyrën Ligjore për këtë çështje.

Ferit Idrizi, Kryetar i komunës – theksoi se nëse konstatohet se është konfidenciale, atëherë mund të vjen vetëm numri i të punësuarve.

Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së – deklaroi se si listë e të punësuarve (vetëm emri dhe mbiemri) nuk është konfidenciale.

Agron Perçuku, anëtar i KPF-së – sipas meje, nuk po e shoh të arsyeshme të vjen lista. Por, kushdo që dëshiron ta ketë listën e punëtorëve, mund të kërkoj qasje në dokumente zyrtare sipas ligjit.

3. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për caktimin e normave tatimore të pronave.

Isuf Jashari, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa – tha se në bazë të Ligjit nr. 08/L-224 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, Departamenti i Tatimit në Pronë e ka vërejtur se ekziston një paqartësi rrëth caktimit të normave tatimore për vitin 2024. Andaj, kuvendet komunale duhet që deri më 30 nëntor 2023 t'i caktojnë normat tatimore. Ai tha se për vendbanimet parësore është ngritur vlera nga 15 mijë në 30 mijë të pronës së vlerësuar. Ai tha se risi është edhe tatimi i pronave bujqësore nga viti 2024. Prandaj, para juve e keni propozim – vendimin.

Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së – kërkoi që për kuvend t'i bashkëngjitet edhe vendimi i kuvendit nga viti i kaluar, në mënyrë që të bëjmë krahasime. Ai tha se e kundërshton rritjen e tatimit për shtëpi apo banesa, sepse preken direkt ekonomitë familjare. Një kategori që ju e kishit zvogëluar, e sipas meje du të rritet shkalla tatimore është pishinat dhe fushat sportive.

Ilmi Azemi, anëtar i KPF-së – deklaroi se çdo vit duhet të bëhet një lloj rivlerësimi i pronave dhe i gjendjes së përgjithshme. Në rastin konkret, nuk kemi njohuri për këtë vlerësim nga ministria, po ashtu nuk e dimë as në sa zona është ndarë komuna jonë.

Normat e propozuara nuk janë të koordinuara me realitetin.

Isuf Jashari, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa – deklaroi se ne kemi bërë një analizë të madhe për caktimin e normave tatimore, për shkak se komuna jonë i ka 25 zona, kurse niveli qendror e ka bërë vlerësimin. Duke u bazuar në këtë zbritje për vendbanimin

primar nga 15 mijë në 30 mijë euro, mbi 60% (edhe me këtë normë të propozuar 0.20%) do të lirohen nga tatimi. Me këtë normë, të gjitha objektet banesore deri në 75m² nuk do të tatumohen fare.

Ilmi Azemi, anëtar i KPF-së – pasi që është bërë analizë, atëherë sa do të jenë të hyrat vetanake të komunës me këtë propozim për vitin 2024? Propozimi im është që të ulemi edhe një herë edhe ta analizojmë dhe t'i caktojmë normat që janë në interes të qytetarëve dhe të komunës. Pra, të mbahet edhe një mbledhje e KPF-së para seancës së kuvendit.

Sylejman Meholli, anëtar i KPF-së – nuk mora përgjigje nga drejtori se a po zbatohet vendimi i qeverisë për faljen e borxheve deri në 100 euro. Edhe une pajtohem që duhet edhe një analizë tjetër më e thuktë dhe gjithpërfshirëse. Pajtohem që këto janë të hyrat kryesore për komunën, por mund të jenë barrë për qytetarët. Komuna duhet të synoj që t'u lehtësojë mundësitë edhe pjesës komerciale. Te pronat komerciale të pamerrëmetuara, këto janë objekte që po ndërtohen për t'u hap ndonjë biznes, por që nuk kanë hy në funksion ende. Sipas meje, këtyre duhet t'iu zbritet norma dhe t'iu krijohet një klimë më e favorshme për të operuar.

Ferit Idrizi, Kryetar i komunës – tha se ky propozim le të procedohet kështu si është për kuvend. Kurse, propozoi që shefat e grupeve kuvendare më datën 27 nëntor 2023 të vijnë në takim në zyrën time dhe bashkërisht e analizojmë edhe një herë.

Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim. Kurse, më datën 27 nëntor 2023, shefat e grupeve kuvendare të marrin pjesë në takim me kryetarin.

4. Shqyrtimi i Informatës lidhur me zbatimin e Planit Zhvillimor Komunal.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të plotësohet dhe të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

5. Shqyrtimi i Informatës lidhur me rezultatet (ecurinë) e dhënies në shfrytëzim të pronës komunale.

Agron Perçuku, anëtar i KPF-së – pyeti se a është funksionalizuar sektori i pronës? Në informatë kemi të pasqyruara se komuna ka nën menaxhim 53 kontrata, ku gjatë periudhës janar-nëntor 2023 janë inkasuar 17776.81€. Është një inkasim shumë i ulët. Ka mundësi që shumicës së kontratave iu ka skaduara afati e janë duke operuar pa afat. A keni informacione se a kemi të bëjmë me skadim të kontratave?

Sylejman Meholli, anëtar i KPF-së – kjo informatë duhet të plotësohet për kuvend dhe t'i bashkëngjiten së paku: titujt e kontratave (ta dimë se për cilën parcelë po bëhet fjalë), data e lidhjes së kontratës, data e skadimit (nëse dikujt i ka skaduar), shuma e qirasë.

Remzi Ahmeti, drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë – deklaroi se po shpresoj që në vitin 2024 do të funksionalizohet sektori i pronës, sepse nuk kemi zyrtar kompetent që merret me këtë çështje. Zyrtari ligjor është i stërvngarkuar me punë. Ai tha se

sa u përket kontratave është material voluminoz që të dërgohet në kuvend. Kush ka interes mund të vjen dhe ti shikon. Komisioni i kuvendit e ka pasur derën e hapur tek unë dhe kërkesat e tyre i kemi trajtuar me prioritet.

Ku kam marrë informacione, kemi marrë masa ligjore.

Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së – theksoi se s'po kërkon kontratat, por titujt e kontratave me elemente tjera përcjellëse që i ceka më herët.

Agron Perçuku, anëtar i KPF-së – tha se si komision i kemi trajtuar këto kontrata dhe do ta sjellim raportin në kuvend. Ai kërkoi që të shqyrtohen kontratat e skaduara.

Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të plotësohet informata dhe të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

6. Shqyrtimi i Informatës për menaxhimin e mbetjeve në Komunën e Vushtrrisë.

Ilmi Azemi, anëtar i KPF-së – tha se nga 1 janari 2024 do të bëhet inkasimi i mbeturinave nga NPL “Përparimi”. A janë bërë përgatitjet e duhura nga kompania për këtë çështje?

Ferit Idrizi, Kryetar i komunës – deklaroi se është optimist që kompania do ja del, sepse kam biseduar me menaxhmentin dhe më kanë njofuar se janë të gatshëm për një gjë të tillë.

Agron Perçuku, anëtar i KPF-së – a ka marrëveshje në mes dy kompanive për çështjen e punëtorëve?

Ferit Idrizi, Kryetar i komunës – kam biseduar me dy kryeshefat e kompanive, por për detaje mund t'i thërrasim kryeshefat në kuvend, sepse detajet nuk i di.

Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së – pyeti se me subvencionet që i ka ndarë kuvendi, çfarë ka ndodhur?

Benjamin Shala, drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike – deklaroi se subvencionet që i ka ndarë kuvendi janë blerë makineri nga ndërmarrja.

Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së – pyeti se a rrezikohet stabiliteti financiar i kompanisë nga numri i madh i të punësuarve?

Ferit Idrizi, Kryetar i komunës – NPL “Përparimi” është ndërmarrje e pavarur dhe për detaje mund t'i thërrasim në kuvend për t'u përgjigjur.

Agron Perçuku, anëtar i KPF-së – Bordi i aksionarëve duhet të ftohet në kuvend për t'iu përgjigjur pyetjeve e jo menaxhmenti i kompanisë.

Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

7. Shqyrtimi i Informatës lidhur me strukturën e bizneseve, numrin e të punësuarve dhe zhvillimin e bizneseve në Komunën e Vushtrrisë.

Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së – kërkoi që për kuvend kësaj informate t'i bashkëngjitet lista e bizneseve të shuara.

Ergin Sunguri, drejtor i Drejtorisë për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural – deklaroi se për kuvend do e bashkëngjesim listën e bizneseve të shuara.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të plotësohet dhe të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

8. Të ndryshme.

Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së – kërkoi sqarime se pse nuk u hudh në votim propozimi i saj për financim të librit.

Melihate Basholli - Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF- së – deklaroi se nuk kërkove që të futet në votim. Mendova që pas sqarimeve të kryetarit, i cili tha që kërkesa të shkoj në zyrën e kryetarit dhe ata e përgatisin materialin për kuvend. Prandaj, kjo ishte arsyjeja.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

Bujar Klinaku

Bujar Klinaku

Procesmbajtës

Melihate Basholli Latifi

Melihate Basholli Latifi

Kryesuese e KK-së dhe KPF- së

